

veze



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQESISE E USHQIMIT
Drejtoria e Veterinarise

Nr prot. 1927

Rregullore

Nr 3 Date 25.05.2005

Mbi

Kushtet sanitare- veterinarë të eksportimit të pulave dhe vezeve për inkubim në vendet e BE-se.

Në mbështetje të Nenit 119 të Kushtetutës së Republikës Shqiptare,
të Ligjit Nr. 9308 datë 4.11.2004 "Për Sherbimin dhe Inspektoriatin Veterinar",

Direktives Nr.90/539/CEE "Mbi kushtet shëndetsore të tregtimit, importimit nga vendet e treta të pulave dhe vezeve për celje datë 15 Tetor 1990.

Ministri Bujqësisë dhe Ushqimit nxjerr këtë rregullore.

Neni 1.

Kjo rregullore përcakton masat sanitaro-veterinare, që zbatohen në pularitë që ndodhen në Republikën e Shqipërisë për eksportimin e pulave dhe vezeve për celje për në vendet anëtare të BE-se.

.....

Neni 2

Per qellimet e kesaj Rregulloreje, termat e meposhtme kane kete kuptim:

1. Pule-nenkupton pulen, gjelat e detit, rosa, pata, pellumbat, fazanet per prodhim mishi, vezesh.
2. Zogj 24 oresh-nenkupton te gjitha pulat me moshe me pak se 72 ore ose me teper te caktuara per prodhim mishi apo vezesh dhe qe nuk kane filluar te ushqehen.
3. Shpend prodhimi-nenkupton shpend nen 72 ore ose me teper per prodhim mishi ose vezesh per konsum.
4. Shpend per therje-shpend I derguar direct ne thertore Brenda 72 oresh.
5. Tufe-nenkupton te gjitha shpendet me te njejtin status shendetsor te mbajtur ne te njejtin vend dhe qe perbejne nje unitet te vetem epidemiologjik. Ne shpendet e mbajtur ne ambient te mbyllur ky unitet perfshin te gjitha zogjte qe rriten ne te njejten hapsire ajrore.
6. Ferme-nenkupton ndermarrje qe perdoret per mbajtjen e shpendeve per race ose prodhim.
7. Ndermarrje- nenkupton nje instalim qe perdoret per qellimet e meposhtme:
 - a. per pune racore, per prodhim vezesh per inkubim dhe celje zogjsh, per prodhim te pulave te races.
 - b. pulari per pune racore, per prodhim vezesh per inkubim, per prodhimin e pulave te prodhimit te vezeve.
 - c. repart inkubimi- ambiente te vecanta brenda ndermarrjes per inkubimin e vezeve.
8. Veteriner I autorizuar-nenkupton veterinerin e instruktuar nga autoriteti kompetent veterinary nen pergjegjesine e tij qe te beje kontrollet e parashikuara ne kete rregullore ne nje pulari te vecante.

9. Laborator I miratuar-nenkupton nje laborator qe ndodhet ne territorin e Republikes se Shqiperise I miratuar nga autoriteti competent veterinary nen pergjegjesine e tij per te bere teste diagnostike te parashikuara nga kjo rregullore.

10. Inspektim shendetsor-eshte nje vizite e bere nga veterineri I autorizuar per te bere inspektimin e statusit shendetsor te pularive.

11. Semundje e detyrueshme per lajmerim-jane Pseudopesti dhe Influenca aviare.

12. Station karantine-ambient dhe paisje te nevojshme ku mbahen shpendet ne izolim komplet, larg nga kontakti direkt apo indirekt me shpende te tjere per te lejuar vezhgimin me afat gjate si dhe testimin per Pseudopest dhe Influence aviare.

13. Therje sanitare-nenkupton shkaterrimin sipas masave shendetsore perfshire dezinfektimin e te gjitha pulave dhe produkteve ne vater te cilat jane te infektuara ose dyshohen si te tilla.

Neni 3.

Si Laborator Kombetar Reference sherben Instituti Kerkimeve Veterinare i cili eshte pergjegjes per Koordinim e metodave diagnostike te percjelle ne kete Rregullore si dhe venien e tyre ne zbatim nga Labororet Rajonal qe ndodhen ne territorin e Republikes Shqiperise.

Neni 4.

Ne menyre qe te eksportohen per ne vendet e BE-se, pulat per prodhim vezesh si dhe vezet per ne inkubim dhe zogjte 24 oresh, duhet te plotesojne kushtet e meposhtme:

1. te origjinojne nga pulari me numer dallues te dhene nga autoriteti competent veterinary.
2. ne momentin e ngarkeses te mos jene objekt masash kufizuese sanitaro-veterinare per shkak te ndonje semundje qe prekin shpendet.
3. pularit e eksportit te pulave per prodhim vezesh, te vezeve per inkubim dhe zogjve 24 oresh nuk duhen te ndodhen ne zonat te cilat kane qene dhe

jane objekt masash sanitaro- veterinare per shkak te ndonje vatre semundjeje infective.

4. ne momentin e ngarkimit ne mjetin e transportit tufa e pulave te mos c'faqe shenja klinike te ndonje semundje infective.

Ne momentin e ngarkimit per transport vezet per inkubim duhen:

5. te jene prodhuar nga tufa te cilat per me te teper se 6 jave kane qendruar ne nje pulari te miratuara nga Autoriteti Kompetent sipas Nenit 4 pika 1.

6. 72 ore para ngarkimit, te jete bere ekzaminimi sanitaro-veterinar, dhe ka rezultuar qe kjo tufe nuk paraqet shenja klinike ose dyshime te ndonje semundje infective.

7. te jete bere inspektimi mujor sanitaro-veterinar nga veterineri i shtetit (zyrtar). Vizita e fundit te jete bere 31 dite perpara ngarkimit.

8. Per Statusin Shendetsor te tufes, te mbahet regjister.

9. Ngarkesa e vezeve per celje te jete dezifektuar sipas instruksioneve te dhena nga veterineri i shtetit (zyrtar).

N.q.s. gjate kohes qe vezet jane ne inkubim c'faqet semundje ngjitese ne tufen qe ka furnizuar keto veze, Autoriteti Kompetent Veterinar i inkubatorit duhet te informoje per tufen e origjines.

Neni 5.

Pulat per therje (mish), ne momentin e ngarkimit duhet te plotesojne keto kushte:

1. te vijne nga nje pulari ku jane mbajtur (kane qendruar) qysh nga celja ose ne teper se 21 dite.

2. kjo pulari te mos kete qene subject i ndonje mase kufizuese sanitaro-veterinare qe zbatohet ne shpend.

3. 5 dite perpara dergimit, ekzaminimi sanitaro-veterinare i bere nga vete veterineri i shtetit, te mos kete zbuluar shenja klinike te ndonje semundje infective ne shpend.

4. pularia derguese te mos ndodhet ne zona ku per arsye te shendetit te kafsheve jane marre masa sanitaro-veterinare sipas legjislacionit veterinar ne fuqi, per shkak te ndonje vatre te semundjeve qe infektojne shpendet. Kushtet e parashtruar nga ky Nen zbatohen dhe per zogjt mbi 72 oresh dhe per shpendet qe perdoren per furnizim rezervatesh gjuetie.

Neni 6.

Ne rast se ngarkohen per eksport pula dhe veze per inkubim nga pulari te cilat vaksinohen pulat kunder Pseudopesti zbatohen rregullat e meposhtme:

1. vezet per inkubim duhet te merre (grumbullohen) nga tufa te cilat jane vaksinuar ose jane vaksinuar me vaksine te inaktivuar. Kur per vaksinimin perdoret vaksine e gjalle, vaksinimi te jete bere 30 dite perpara mbledhjes se vezeve per inkubim.
2. zogjte 24 oresh si dhe zogjte qe perdoren per plotesimin e rezervateve te pjahut nuk duhen te vaksinohen kunder Pseudopestit dhe duhen te jene celur nga veze te cilat vijne nga inkubatore ku praktikat e punes sigurojne qe veze te tillate jete inkubuar ne kohe dhe reparte teresisht te ndara nga veze te cilat nuk plotesojne kushtet e pikes 1.
3. pulat qe pjellin veze per celje duhet te mos jene te vaksinuar kunder Pseudopestit dhe te kene qene izoluar 14 dite perpara ngarkimit nje stacion karantine nen vezhgimin e veterinerit te shtetit. Asnje pule ne pularine e origjines opa stacionin e karantines te mos jete vaksinuar kunder Pseudopestit 21 dite para ngarkimit. Asnje zog qe nuk do te ngarkohet te mos jete ne pulari apo ne stacion te karantines. Ne stacion te mos aplikohen vaksinime, 14 dite perpara ngarkimit te behet testim serologjik nga i cili kane dale rezultate negative per gjetjen e antitropave kunder pseudopestit.

Neni 7.

Program i detyrueshem i Kontrollit te Semudjeve qe prekin pulat duhet te permbaje , shperndarjen e semundjes ne territor, arsyet e programit,

rendesine qe paraqet semundja, raporti cost/ benefit i programit, zonen gjeografike ku do te zbatohet , kategorite e statuseve qe do te jepen pularive, procedurat e testeve qe do perdoren, veprimet qe ndermerren kur ndonje pulari humbet statusin e saj, masat sanitaro-veterinar ne rast se testet e parashikuara nga programi dalin positive.

Neni 8.

N.q.s. Autoriteti Kompetent Veterinar gjykon qe territori i Republikes Shqiperise ose pjese te ketij territori jane te pastra nga semundje qe prekin pulat, atehere ky Autoritet duhet ti paraqese Komisionit European dokumenta ne menyre qe te vertetohet nje gje e tille duke nenvizuar vecanerisht:

- natyren e semundjes dhe historikun e saj ne territorin e Republikes se Shqiperise ose pjese te ketij territori.
- rezultatet e testeve serologjike mikrobiologjike si dhe faktin qe lajmerimi i nje semundje te dhene nga Autoriteti Kompetent Veterinar percaktohet me ligj.
- periudhen e survejimit(mbikqyrjes).
- periudhen e ndalimit te perdorimit te vaksines si dhe zonen gjeografike qe perfshin ky ndalim.
- mjetet e perdorura per te verifikuar qe kjo zone mbetet e paster nga semundja.

Neni 9

Zogjt 24 oresh dhe vezet per inkubim (celje) duhen te transportohen:

- 1.me konteniere qe perdoren vetem nje here dhe pastaj konfiskohen.
- 2.me konteniere qe perdoren prape por me kusht qe te pastrohen dhe te dezinfektohen. Kontenieret duhet te transportojne vetem zogj 24 oresh ose veze per inkubim te te njejtij lloj, kategorie dhe tipi shpendi. Zogjte 24 oresh dhe vezet per inkubim duhet te vine nga e njejta pulari.
- 3.konteneri duhet te jete i vulosur me emrin e Republikes se Shqiperise si dhe rajonin e origjines, me numrin e miratimit te pularise,me numrin e zogjve dhe vezeve per cdo boks, llojin e shpendit te cilit i perkasin zogjte dhe vezet.
- 4.bokset e zogjve dhe vezeve per inkubim te grupohen per transportim ne konteniere te pershtatshem.
- 5.pulat e races dhe per prodhim vezesh duhet te transportohen ne kafaze te mbulueshme qe mbajne pulat te shpendit te njejtij lloj,kategorie,tipi dhe qe vijne nga e njejta pulari.

6. pulat e races per prodhimin e vezesh si dhe zogjt e 24 oresh duhen te dergohen pa vonese ne pularine e destinacionit pa ardhur ne kontakt me zogjt e tjere te gjalle perjashto shpendet per prodhim vezesh, shpend te races ose zogjt 24 oresh te cilet plotesojne kushtet e vendosura nga kjo Rregullore.

7. kafazet e transportit te pulave duhen te jene te ndertuar ne menyre te tille qe te mbledhin jashteqitjet (fekalet) dhe puplat gjate transportit, dhe njekohesisht te jene te pastrueshem dhe te dezinfektueshem.

8. kamionet, kontinieret, kafazet para ngarkimit duhen te jene te pastruara dhe te dezinfektuara sipas instruksioneve te Autoritetit Kompetent Veterinar.

Neni 10.

Shpendet qe permenden ne Nenin 9, nuk duhen te transportohen duke kaluar neper zona te infektuara nga Influenca Aviare dhe Pseudopesti, perjashto rastet kur ky transport behet me tren.

Neni 11.

Ne menyre qe Republika Shqiperise te futet ne listen e vendeve te treta qe mund te eksportojne shpend dhe veze per inkubim per ne vendet e BE-se duhet patur parasysh:

- gjendja shendetsore e pulave qe mbareshtohen, kafsheve te tjera shtepiake dhe te egra, gjendja shendetsore e kafsheve ne zonen perreth.
- rregulli dhe shpejtesia e dhenies se informacionit nga ana e Autoritetit Kompetent Veterinar per ekzistencen e semundjeve infektive ne territorin e Republikes se Shqiperise vecanerisht per semundje qe bejne pjese ne listat A dhe B te OIE-se.
- rregulloret e pergatitura nga Autoriteti Kompetent Veterinar per parandalimin dhe kontrollin e semundjeve ne kafshe.
- struktura e Autoritetit Kompetent Veterinar dhe pushteti qe ka ky Autoritet.
- organizimi dhe zbatimi i masave parandaluese dhe kontrolli semundjeve infektive ne kafshe.